

Fejton: “Pavarësia dhe fati i minoriteteve (1991 - 1992)” (6)


Toleranca evropiane e Alija Izetbegoviqit

“Toleranca ime nuk është evropiane, është myslimane. Nëse jam tolerant, jam tolerant se jam mysliman. Unë e respektoj Evropën, por besoj se ka një mendim shumë të lartë për veten”, thoshte Izetbegoviq më 1994

Alija Izetbegoviq po përpiquej të gjente një përgjigje adekuate për regjimin e burokratizuar, nën të cilin jetonin boshnjakët dhe jugosllavët. Jugosllavia komuniste, megjithatë, ishte një regjim autoritar që nuk i toleronte kritikën. Luftën e tij Izetbegoviqi përpiquej ta bënte nëpërmjet parimeve etike që i kishte nxënë në Kuran. A nënkuptonin këto parime edhe dominimin ndaj të tjerëve? Të gjitha religjionet e kanë detyrë t'i bëjnë të tjerët të besojnë, të pranojnë fenë e tyre. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se Izetbegoviqi kishte qëllime të

tilla. Ai konsideronte se nacionalizmi ishte një luks. Më 1984 ai e shkroi librin “Islami ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes” që nuk mund të botohej në ish-Jugosllavi dhe e pa dritën në Amerikën e Veriut. Pak për shkak të këtij libri (ende të pabotuar), e pak për shkak të disa ideve që i kishte thënë publikisht, Izetbegoviq është burgosur dhe është liruar më 1988 - pas, siç thotë vetë - dy mijë e shtatëdhjetë e pesë ditësh. Gjatë qëndrimit në burg, Izetbegoviq shkroi më se 3500 aforizma, komente që i botoi pas daljes nga burgu. Gjatë gjithë

jetës së tij, ai ka qenë tolerant: “Zot më ndihmo nëse e kam gabim, por unë e respektoj një të krishterë të mirë më shumë se një mysliman të keq”. Assesi nuk ishte fundamentalist. Më 1994, një gazetar gjerman e kishte karakterizuar Izetbegoviqin si “një mysliman me orientime evropiane për traditën dhe tolerancën, i hapur ndaj botës”. Izetbegoviq është përgjigjur: “Toleranca ime nuk është evropiane, është myslimane. Nëse jam tolerant, jam tolerant se jam mysliman. Unë e respektoj Evropën, por besoj se ka



Alija Izetbegoviq

një mendim shumë të lartë për veten”. Megjithatë, qëllimet e tij nuk ishin të ndërtohet një shtet islamik. (“Nuk dua një shtet islamik, por dua që islami të mbetet gjallë në këtë pjesë të botës”). Ai shpresonte të krijonte një shtet, në të cilin “askush nuk do të përndiqet për shkak të

religjionit të tij, për shkak të besimit, kombësisë ose bindjeve politike”. “Ky do të jetë ligji ynë”, pat thënë Izetbegoviq.

(Në numrin e ardhshëm: Si e shfrytëzuan religjionin serbët kundër Izetbegoviqit?)

Fejton: “Al Capone: kumbara i nëntokës” (8)

Incidenti me prokurorin

O'Donnell e dinte fare mirë se nuk ishte punë me mend të shkonte e të pinte raki në lokalin e rivalit të tij, Al Capones. Ai po ashtu, e dinte se Capone nuk ishte aq budalla sa ta vriste në prani të prokurorit shtetëror McSwiggin, me të cilin ishte ulur të pinte raki. Mirëpo, kishte në gjithë këtë punë një gjë që O'Donnell nuk e dinte...

Al Capone i kishte vënë punët në dyzen. Pas masakrës së “Adonisit” gazetë nisën të shkruanin për të si për “gangsterin më të shquar në botë”. Biznesi me kontrabandë të alkoolit po i ecte si mos më mirë. Pos Chicagos po i dridhej edhe i gjithë New Yorku. Për më tepër,

në atë kohë të papunësisë, burra të botës po shtyheshin në rend që të punonin për të. Mirëpo, që punët të mos shkonin krejt në dyzen u kujdes prokurori Billy McSwiggin, i cili dy vjet më parë qe përpjekur ta akuzonte Caponen për vrasjen e Joe Howardit. Ishte pranvera e vitit

1926. Prokurori McSwiggin kishte qenë në vizitë të babait, ish-polic i Chicagos, dhe tani po shkonte të luante letra me dy shokë të tij: Red Duffyn dhe Jim Doherty. Ishin nisur për njërin nga lokalet e Capones në Chicago. Rrugës u ishte prishur vetura dhe një biznesmen me alkool i quajtur Klondike O'Donnell i kishte parë rrugës dhe ishte ofruar t'i dërgonte deri në lokal. Pak minuta më pas të katër irlandezët ishin ulur në lokalin e Capones, duke pirë raki dhe duke luajtur letra. Mirëpo, për njerëzit e Capones, hyrja në dyqan e një njeriu si O'Donnell nuk ishte punë e mirë. Ata e konsideronin atë rival biznesi dhe ardhjen e tij në lokal e kishin konsideruar fyerje. O'Donnell e kishte ditur mirë që hyrja e tij në lokalin e Capones nuk ishte punë shumë e mençur, por e dinte edhe se Capone nuk do të guxonte ta vriste para prokurorit. Mirëpo, ai nuk e dinte një gjë shumë të rëndësishme: Capone nuk po e dinte se me O'Donnellin ishte edhe prokurori McSwiggin. Kur katër irlandezët dolën nga lokali të dehur, patën kohë vetëm të shikonin nga parkingu, para se të kaploheshin nga një breshëri plumbash automatiku. O'Donnell, Dyff, Doherty dhe prokurori McSwiggin kishin mbetur të vdekur.

E gjithë bota iu hodh në qafë Capones. Qeveritarët e dinin se prokurori kishte qenë në prani të biznesmenëve ilegalë të alkoolit, por ishin zotuar t'ia vinin lakun në fyt Capones. Policia nuk po mund të gjente dëshmi kundër Capones, por organizoi shumë aksione bastisjesh në lokalet e



Hymie Weiss është gjetur i vvarë skaj rruge. Ishte vetëm 28 vjeç

Gangsterë të tjerë të shquar

Yoshinori Watanabe

Mafia e Japonisë quhet me emrin Yakuza. Shefi më i njohur i Yakuzës është Yoshinori Watanabe. Më 1960, si 19-vjeçar Watanabe i është bashkuar bandës Yamaguchi Gumi Clan në Cobe dhe është dëshmuar si një vrasës i rrezikshëm. Kjo ka bërë që ai të nderohet nga shefat e bandës. Pas vrasjeve misterioze të disa kandidatëve për shef, Watanabe është bërë shef i Yamaguchi Gumi Clan më 1988.

Sot e kësaj dite vepron në Japoni i papenguar nga policia. Bën jetë të qetë e të zakonshme: del të vrapojë, ushtron karaoke, nuk ushqehet në restaurante të shtrenjta. Konsideron se yakuza është shumë gjë më e mirë se krimi i zakonshëm dhe i paorganizuar. “Nëse në Japoni shfaqet ndonjë kriminel, Yakuza do ta shkatërrojë, sepse ai do t'ua prishë biznesin”, thotë një polic japonez. “Prandaj, Yakuza i mbron njerëzit e zakonshëm nga agresivitetet e kriminelëve më mirë se policia”.

tij, ia dogji disa lokale dhe ia prishi disa biznese. Al Capone u zu pisk. Vendosi të fshehej. Për tri muaj ai jetoi jashtë Amerikës: në Kanada dhe në Itali. Gjatë kësaj kohe nisi të mendonte seriozisht mos ishte më mirë të tërhiqej përfundimisht nga punët ilegale. Kur jeta në ilegale iu mërzit, vendosi të kthehej në Chicago pas tre muajsh në “ilegalë” dhe të përballej me akuzat për vrasje. Në gjykim doli se prokurorët nuk kishin dëshmi të mjaftueshme dhe, së shpejti, Capone doli në rrugë si njeri i lirë.

Duke qenë i rrezikuar nga policia, Capone donte të lidhte sa më shumë miq. Në këtë situatë, ai vendosi që të lidhte paqe edhe me Hymie Weissin - shokun e Dion O'Bannoit të ndjerë, i cili kishte bërë atentat në shokun e Capones Johnny Torrión. Weiss ende nuk e kishte harruar inatin për vrasjen e Dionit dhe e refuzoi ofertën e Capones. Të nesërmen u gjet i vdekur skaj udhe. Pas kësaj askush më nuk kishte guxim t'i refuzonte ofertat “për paqe” të Capones. Madje, Capone organizoi edhe një “konferencë të paqes”, në të cilën i mbledhi shefat e grupeve mafioze. Aty ai arriti marrëveshje me shefat që të ndërpriteshin vrasjet e reja dhe të faleshin të gjitha gjakrat e vjetra.

Për dy muaj të tërë në nëntokën e Chicagos mbretëroi paqja. Pastaj, dikush e vrau Theodor Antonin, “Grekun Toni”, shokun e ngushtë të Capones.

(Nesër: Pse i thirri disa gazetarë Capone për t'u gatuar shpageta? Kush ishte “Big Bill” Thompson? Si u shoqërua Capone me boksierin Jack Dempsey? Si mbeti puna e Grekut Toni?)

AltaVia Travel

Fluturoni më lirë dhe më mirë

Telefono **543 543**

Londra

EUR 172 + taksat, *një drejtim

EUR 240 + taksat, *kthese

EUR 480 +taksat

New York, kthyes*

EUR 530 +taksat

Toronto, kthyes*

EUR 590 +taksat

Washington, kthyes*

*Me hotel dhe transfer falas

EUR 519 +taksat

Dubai, kthyes

038 543 543, 044 543 543

info@altaviatravel.com

www.altaviatravel.com